



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 260/18 prot.,

Datë 03.03.2026

V E N D I M
Nr. 337/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 271/2026, datë 18.02.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-73621-01-05-2026 me objekt: “Blerje materiale për sektorin e mirëmbajtjes”, me fond limit 5,996,700 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Cërrik.
- Ankimues:** Operatori ekonomik Ervin Luzi me Nipt K71707007Q dhe adresë: Lagjja Katund i Ri, Rruga Ali Pashe Gucia, Godina nr.5, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Cërrik
Lagja nr.2 rruga “Gjimnazistet 1962”, Cërrik
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Agron Balukja” me Nipt L72909202H dhe adresë: Lagja “Clirimi”, Rruga “Sul Misiri”, Zona kadastrale 8522, Pasuria nr 10/340, Elbasan
- Operatori ekonomik “T & J Konstruktion” SHPK me Nipt M29718101T dhe adresë: Lagjja Teqe, zk.2908, pasuria nr.7/90, Peqin
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 18.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 271/2026, ku vendosi:

[.....]

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik Ervin Luzi në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-73621-01-05-2026 me objekt: “Blerje materiale për sektorin e mirëmbajtjes”, me fond limit 5,996,700 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Cërrik.*
2. *Autoriteti Kontraktor të rivlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë Agron Balukja dhe “T & J Construction” SHPK sipas konstatimeve të këtij vendimi duke i s’kualifikuar ata*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues Ervin Luzi*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. ” [...]

I.2. Me shkresën nr. 671/1 prot., datë 24.02.2026, protokolluar me tonën nr. 260/15 prot., datë 26.02.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Cërrik, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 271/2026 datë 18.02.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 671/1 prot., datë 24.02.2026, protokolluar me tonën nr. 260/15 prot., datë 26.02.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Cërrik, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 271/2026 datë 18.02.2026.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP Nr. 271/2026, datë 18.02.2026

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me REF-73621-01-05-2026 me objekt: “Blerje materiale për sektorin e mirëmbajtjes”, me fond limit 5,996,700 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Cërrik.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Florent Zguro

